



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA KORÇË

19.09.2023

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: **Pyllëzime Krushovë**

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Mbjellja e pemëve 77211600-8

Shërbime të pyllëzimit 77231600-4

Shërbime mbjellëse 77315000-1

VLERA E FONDIT LIMIT: **15.731.666** (pesëmbëdhjetë milion e shtatëqind e tridhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë) lek,pa tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor **Bashkia Korçë**ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TËKUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.1.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2020,2021,2022**, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit të kontrates.

Argumentimi: *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.*

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Ky kriter i sherben autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës, prandaj është kërkuar që vlera e xhiros të jete sa vlera e përlllogaritur e fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 43 pika 2/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar dhe nenin 77 pika 3 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në nenin 43 pika 1 e VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, në zbatim të Ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave Nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, VKM-së Nr. 922 datë 29.12.2014 "Për deklarimin e detyrueshëm të deklaratave tatimore dhe të dokumenteve të tjera tatimore, vetëm nëpërmjet formës elektronike", si dhe kërkesave të Ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

2.1.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2020,2021,2022, të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve të Ligjit nr.10091,date 05.03.2009 ”Per auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c, **Bilancet nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës **31 mars të vitit pasardhës**, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel te Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009: “Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikim të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese: "c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur, në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i) totali i aktiveve të bilancit, në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh; ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh; iii) ka, mesatarisht, 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël”.

2.2 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.2.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për shërbimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes te njoftimit te kontrates, në një vlerë jo më të vogël se 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate .

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe faturave tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastet kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara. Në rastet kur në faturat tatimore nuk përfshihen të gjitha zërat e shërbimeve, ato duhet të shoqërohen me situacionet ku shënohen datat, shumat dhe shërbimet e realizuara

-Per kontratat e realizuara si Bashkim Operatoresh, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontraten e Bashkimit te operatoreve ekonomikë.

-Per kontratat e realizuara si Nënkontraktor, Operatori ekonomik ofertues duhet te paraqesë gjithashtu edhe Kontratën baze ndermjet Kontraktorit dhe Autoritetit Kontraktor si dhe Miratimin zyrtar si nenkontraktor i deklaruar nga ana e autoritetit kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Ne kuader te vleresimit te ofertave ne menyre sa me te drejte, duhet që në rastet e BOE apo Nenkontraktimit, vlerësimi i përvojës të mëparshme të vërtetohet me paraqitjen e kontrates se bashkepunimit apo marreveshjen e nenkontraktimit si dhe me aktin e miratimit te nenkontraktimit leshuar nga Institucioni. Dokumenta keto te nevojshme per te vleresuar lidhur me punet konkrete qe ka kryer OE si anetar i BOE,apo si nënkontraktor. Ky dokumentacion disponohet nga çdo OE si në rastin kur ka qene pale në Bashkimin e OE ashtu dhe në rastet kur ka qene Nënkontraktor. Ky dokumentacion është lehtësisht i aksesueshëm dhe është pjesë e dosjes së zbatimit të punimeve të kontratës që duhet ta kete çdo kompani në dosjen e saj, per rrjedhoje nuk mund te sjelle kufizim te pjesmarrjes se OE ne tender as ne menyre direkte dhe as ne menyre indirekte.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanëpërvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që shërbimet e mëparshme të ngjashme të jenë ne vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit,që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin 41, pika 3 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

2.2.2 Liçensa profesionale, certifikime lidhur me ekzekutimin e shërbimeve:

a.Licence, “Kodi III.7.A Shërbime të ekspertizës dhe/ose profesionale lidhur me pyje dhe/ose kullota “leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit, për ushtrim e aktivitetit objekt i prokurimit.

b.Licence, Kodi II.4, për “Prodhim, tregtim fara dhe fidane” leshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit

Në rast se operatorët ekonomik nuk janë prodhues të fidanëve ata duhet të paraqesin Autorizimin e prodhuesit/distributorit të autorizuar nga prodhuesi për furnizimin me fidanët e kërkuar, të shoqëruar me Liçencën Kodi II.4 nga QKB të prodhuesit dhe Çertifikatën fitosanitare lëshuar në emër të prodhuesit.

Në rast se autorizimi do të lëshohet nga distributori ai duhet të shoqërohet edhe me dokumentacionin që provon se ai është distributor i autorizuar për furnizimin me keto materiale.

c. Çertifikatë fitosanitare e brendshme e lëshuar nga organet përkatëse të Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit.

Argumentimi :Kërkesat e mësipërme janë përcaktuar bazuar në pikën 2, te nenit 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, ”Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një

veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë” dhe nenin 41, pika 4, gërma a,) dhe pika 6 të VKMnr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik,,ligjit nr. 57/2020 “Për Pyjet”, të ligjit nr.10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”,VKM 538 date 26.05.2009, ”VKM Nr. 538, datë 26.5.2009 ”Per licencat dhe lejet qe trajtohen nga apo nepermjet Qendres Kombetare te Licencimit dhe disa rregullime te tjera nenligjore te perbashketa”,e ndryshuar, Rregullore Nr 3, date 08.07.2009 “Per çertifikimin e sherbimeve te ekspertizes dhe profesionale ne pyje dhe kullota”, Udhëzim Nr. 107, Date 2/12/2002 ”Per krijimin shumezimin perpunimin, tregatimin, kontrollin, vleresimin e fareave dhe fidaneve dhe ruajtjen e trajtimin e materialit gjenetik bimor” dhe Ligjin Nr 10416, datë 7.4.2011 “Per materialin mbjelles dhe shumezues bimor”.

Keto kritere jane vendosur me qellim qe te vertetohet se operatoret ekonomike qe do te marrin pjese ne kete procedure prokurimi disponojne licencat dhe certifikimin e nevojshem per realizimin me sukses te objekt i kontrates.

Me anë të këtyre kritereve kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë se disponojnë licencat profesionale që parashikohen nga legjislacioni në fuqi për kryerjen e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente kompetente.

2.2.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e shërbimeve objekt kontrate, duhet të disponojë personelin kryesor, si më poshtë:

1.Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar nje drejtuesi teknik, **Inxhinier Pyjesh** i cili duhet te jete perfshire ne listpagesa per muajin e e fundit te deklaruar nga data e hapjes se ofertave për të cilin duhet të paraqiten:

I - Diploma

II - Kontrata e punes

III – Listpagesa

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: “Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenit 41, pika 4/ b), të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” dhe në Rregulloren Nr 3 date 08.07.2009 " Per certifikimin e shërbimeve te ekspertizes dhe profesionale ne pyje dhe kullota".

Punesimi i nje drejtuesi teknik me profesion inxhier pyjesh i certifikuar eshte kusht per ushtrimin e veprimtarise objekt i kesaj kontrate per kete arsye eshte pare e nevojshme nevoja per vendosjen e ketij kriteri.

2.2.4 Një punësim mesatar i të paktën **15 personash**, e dokumentuar kjo me Vertetimin e pageses se sigurimeve shoqerore dhe shendetesore nga administrata tatimore.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuara me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter është vendosur bazuar në pikën 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/c të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë punëtore të të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Llogaritja e numrit të punëtorëve është bërë si më poshtë:

Hapja e gropave duhet të kryhet për një periudhë prej 75 ditësh për arsye se gropat duhet të rrinë 1 muaj të hapura për tu rrahur nga agjentet atmosferike. Gjithesëj janë për tu hapur 35 007 gropa, 35 007 gropa : 75 dite = 467 gropa/dite, norma ditore e gropave që mund të hape një punëtor është 55 gropa/dite, 467 gropa/dite : 55 gropa/një punëtor = 9 punëtore për të hapur 467 gropa në ditë. 9 punëtore për të hapur gropat + 2 punëtore për piketimin = 11 punëtorë + 1 drejtuesi teknik + 3 shoferë = 15 persona në total.

Nëpërmjet këtij kushti kërkohet që të vërtetohet se Ofertuesit zotërojnë kapacitetet e nevojshme teknike lidhur me stafin që kanë në dispozicion, si dhe shërbejnë për të provuar se kanë qëndrueshmëri të stafit pa shkëputje nga puna, dëshmi të cilat i japin garancitë e nevojshme Autoritetit Kontraktor mbi përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet e mëposhtëme:

Lloji i Makinerive	Sasia	Pronësia
Mjet Transporti, kamion me kapacitet mbartës mbi 5 ton (për transportimin e fidaneve)	copë 2	në pronësi ose me qera
Autobot (per vaditjen e fidaneve)	Copë 1	në pronësi ose me qera

Per disponimin e mjeteve te mesiperme ofertuesit duhet te paraqesin dokumentacionin e meposhtem:

Ne rast se eshte ne pronesi; leja e qarkullimit, certifikata e pronesise, çertifikata e kontrollit teknik dhe siguracioni i mjetit.

Ne rast se mjeteve eshte me qera;duhet te paraqitet kontrata e qerese vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi e shoqeruar me lejen e qarkullimit, çertifikaten e pronesise, çertifikaten e kontrollit teknik dhe siguracionin e mjetit.

Kjo kërkesë do të quhet e përmbushur gjatë fazës së ofertimit me plotësimin e formularit të vetdeklarimit sipas shtojcës 9 të DST. Bazuar në përcaktimet e nenit 26, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, i ndryshuar “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin”.

Argumentimi: Ky kriter vendoset në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 41, pika 4/ ç, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet e nevojshme për të përmbushur me sukses kontratën.

Mjetet e transportit nevojiten per transportin e fidaneve ne vendin ku do te mbillen. Mbeshtetur ne sasine e fidaneve te percaktuar eshte vleresuar e nevojshme qe kontraktori te kete te pakten 2mjete per transportimin e fidaneve.

Autoboti eshte i nevojshem per realizimin e zerit ujitje fidanesh te percaktuar ne preventiv.

2

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Fondi limit, sasite, termat e references dhe specifikimet teknike janë hartuar nga grupi i punës i ngritur me urdhrin e Kryetarit të Bashkisë Nr. 825, Datë, 18 / 08 / 2023.

Specifikimet teknike dhe termat e references janë sipas materialit i cili do të publikohet sebashku me dokumentat e tenderit.

NJËSIA E PROKURIMIT